

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

Ilda MELO*

Abstrakti: Fenomeni i të miturve jashtë kujdesit prindëror, është një fenomen social i cili ka shoqëruar shoqërinë shqiptare në veçanti pas shndërrimeve politike ekonomike dhe shoqërore të viteve 1990. Për zgjidhjen e problematikave që mbart ky fenomen, shteti shqiptar është kujdesuar për hartimin dhe implementimin e një sistemi të përkujdesit social ndaj të miturve në përputhje me parimin ndërkombëtar të sigurimit të interesit më të lartë të miturit. Kujdestaria dhe birësimi midis të tjerave janë gjetur si zgjidhje ligjore për mbrojtjen e të drejtave të miturve jashtë kujdesit prindëror. Pas prezantimit të përmasave të fenomenit të miturve të ngelur jashtë përkujdesit prindëror në realitetin shqiptar, në këtë studim do të synojmë të japim kornizën ligjore të sistemit të kujdesit social ndaj të miturve jashtë kujdesit prindëror nëpërmjet hulumtimit në legjislacionin shqiptar në mënyrë specifike në sistemin e përkujdesjes sociale në institucionet publike apo private të përkujdesjes. Nëpërmjet trajtimit të standarteve kryesore të shërbimit të përkujdesjes, do të evidentojmë disa nga problematikat që ndeshen gjatë zbatimit në praktikë të tyre si dhe sugjerime për përmirësimin e mëtejshme të standarteve dhe mënyrave konkrete të zbatimit të tyre për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të miturve jashtë kujdesit prindëror.

Fjalë kyç: I mitur, kujdestar, institucion përkujdesjeje, standarde për trajtimin e të miturve.

1. Hyrje

Shndërrime të mëdha politike, ekonomike dhe shoqërore, në Shqipëri, për të siguruar rritje ekonomike dhe zhvillim shoqëror janë shoqëruar me një numër sfidash të panjohura më parë, përfshirë këtu varfërinë, papunësinë e skajshme, mungesën e shërbimeve bazë sociale, përfshirë arsimimin dhe shëndetësinë si dhe valë masive emigracioni. Këto dukuri kanë ndikuar në shfaqjen e kategorive të reja sociale personash të rrezikuar ose në nevojë, përfshirë këtu kategorinë fëmijët jashtë kujdesit të cilët në frymën e dispozitave kushtetuese gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit. Promovimi dhe respektimi i të drejtave të kësaj kategorie përbën tashmë një ndër objektivat kryesore të reformave ligjore në sistemin e kujdesit social të cilat po ndërmerren nga shteti shqiptar. Në realitetin shqiptar ai paraqitet si është një sistem si *formal* ashtu edhe *informal*, me një numër modelesh të ndryshme si birësimi, kujdesi i ofruar nëpër familje, kujdesi tutorial (foster care), kujdesi institucional i tipit rezidencial, kujdesi ditor i ofruar në qendrat për fëmijët me probleme sociale (lypsa, fëmijë rrugësh) apo shërbimet e riatdhesimit dhe të ribashkimit familjar për fëmijët që kanë ikur nga Shqipëria.¹ Midis modeleve të përmendura ato

* Ilda MELO, pedagoge, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

¹ Kanuni i Lekë Dukagjinit - At Shtjefën Gjeçovi, shtëpia botuese "Kuvendi", n. 9, par. 20, fq. 7. Prof. dr. Aurela Anastasi, Prof.dr.Xhezair Zakanjori, Ismet Elezi, K.Nova, E drejta zakonore shqiptare, 1989, fq. 48.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

më të përhapurat janë ai i përkujdesjes së të miturve nga të afërmit e tyre (një model kryesisht informal) si dhe kujdesi institucional i tipit rezidencial pranë institucioneve publike apo jo publike të përkujdesjes ndaj të miturve. Përkujdesja nga të afërmit e të miturit si pjesë e sistemit informal të përkujdesjes është rezultat i zbatimit të disa rregullave zakonore të trashëguara brez pas brezi, rregulla të zbatueshme në zonat malore ku familja patriarkale vazhdon ende të jetë e fuqishme. Një familje e tillë ishte e organizuar në formë piramidale, e renditur sipas autoritetit rezervuar meshkujve, bazuar në lidhjet e gjakut të krijuara nga martesë dhe kishte një kryetar të vetëm. Ishte detyrë e kryetarit të familjes të kujdesej për sigurimin e ushqimit, edukimit dhe krijimit të lidhjeve të reja sociale dhe familjare për pjesëtarët e familjes, për shembull duke realizuar martesë të reja të vendosura vetëm prej tij apo përkujdesjen ndaj të miturve. Familja i rregullonte këto marrëdhënie brenda për brenda saj nëpërmjet të zotit të shtëpisë. Kjo traditë vazhdon të ketë ndikim edhe në ditët tona.

Nëse do t'i referohemi sistemit formal të përkujdesjes, përkujdesja në institucionet e përkujdesjes sociale është forma mbizotëruese e përkujdesjes për këtë kategori të miturish.² Konstatohet në fakt se në krahasim me vende të tjera të rajonit, Shqipëria ka një numër më të vogël fëmijësh që jetojnë në institucione rezidenciale, por dukuria ka prirje në rritje, ndërkohë që kanë ndryshuar edhe kategoritë e fëmijëve. Në vitin 1994 numri i fëmijëve në kujdes rezidencial ishte rreth 400 dhe shumica e tyre ishin jetimë biologjikë. Të dhënat në vitin 2004 apo dhe 2008 tregojnë se numri i fëmijëve në institucionet e kujdesit për fëmijë është rritur tre herë në krahasim me vitin 1994 dhe se shumica e fëmijëve janë “jetimë socialë” dhe “fëmijë me probleme sociale”.

Arsyet e rritjes së numrit të “jetimëve sociale” lidhet përsëri me ndryshimet që kanë ndodhur në Shqipëri në 20 vitet e fundit, ndryshime që kanë pasur një efekt të fortë mbi martesën dhe solidaritetin familjar. Varfëria, emigrimi dhe lëvizjet e brendshme të popullsisë, si dhe ekspozimi ndaj roleve dhe vlerave të ndryshme sociale, kanë dobësuar lidhjet familjare. Si rezultat i dhunës në familje gjykatat raportojnë një rritje të ndjeshme të numrit të divorceve. Masat e Kodit të Familjes të vitit 2003, parashikojnë që në raste divorci, kur nëna merr kujdestarinë e fëmijëve dhe rri në pronën e familjes, babai duhet të kontribuojë për kujdesjen ndaj fëmijës si pjesë e detyrimeve që burojnë nga përgjegjësia prindërore, në praktikë shpesh nuk zbatohen siç duhet. Nëse babai nuk është në gjendje ose nuk do ta mbështesë familjen, nëna shpesh nuk ka mundësi që e vetme të përkujdeset për fëmijët; dhe në shumë raste është e detyruar t'ia besojë fëmijën e vet institucioneve të përkujdesjes. Mbështetja sociale e pamjaftueshme, dhe diskriminimi ndaj grave në fushën e punësimit është mjaft i përhapur duke e bërë shpesh të pashmangshëm këtë fenomen.

² Në nenin 271 të Kodit të Familjes thuhet “Kujdestaria mbi të miturin i cili nuk ka të afërm të njohur ose të aftë për të ushtruar detyrën e kujdestarit mund t'i jepet nga gjykata një institucioni publik dhe privat licencuar për përkujdesjen e fëmijëve”.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

Institucionet e përkujdesjes për fëmijët jashtë kujdesit prindëror sipas legjislacionit shqiptar kanë statusin e personave juridikë që zhvillojnë veprimtari jofitimprurëse nën administrimin e Shërbimit Social Shtetëror, Këshillit të Komunës, Bashkisë, apo Këshillit të Qarkut ku ndodhen këto institucione. Në varësi të llojit të shërbimit social të ofruar mund të jenë:

- Institucione të përkujdesit rezidencial; apo
- Institucione të përkujdesit komunitar.

Shërbimet e përkujdesit komunitar ofrohen në qendra ditore, shtëpitë e individëve, apo në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të grupeve përfituese, si institucionet të përkujdesit komunitar. Ato ofrojnë përkujdesjen dhe ndihmën e tyre pa e larguar fëmijën nga familja e origjinës. Ndërkohë që shërbimi në institucionet rezidenciale ofrohet për individë, për të cilët përkujdesi në shtëpi nuk është i mundur.

Institucionet e përkujdesjes rezidenciale në varësi mënyrës së financimit të personit juridik mund të jenë dy llojesh:

- Institucione publike rezidenciale përkujdesjeje;
- Institucione private rezidenciale të përkujdesjes;

lidhur kjo me faktin nëse shërbimi i përkujdesit rezidencial financohet nga fondet publike apo privatisht.

2. Institucionet publike të përkujdesit social

Deri në vitin 2005 institucionet publike të përkujdesit social kanë qenë nën përgjegjësinë administrative dhe financiare të Shërbimit Social Shtetëror, institucioni ekzekutiv i politikave dhe legjislacionit në fushën e mbrojtjes sociale në Shqipëri që vepron si agjenci shtetërore në varësi të Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.³ Me decentralizimin e shërbimeve sociale këto institucione po përjetojnë fazën tranzitore të kalimit nën përgjegjësinë administrative dhe financiare të organeve të pushtetit lokal, të strukturave përgjegjëse të komunave, bashkive apo qarqeve. Ndërkohë Shërbimi Social Shtetëror ka ruajtur funksionet lidhur me vlerësimin e dokumentacionit të këtyre institucioneve me qëllim licencimin e institucioneve publike apo private si ofrues të shërbimeve sociale, si dhe funksionin e inspektimit për zbatimin e ligshmërisë së veprimtarisë së tyre dhe standarteve të shërbimeve të ofruara, të cilat i ushtron nëpërmjet strukturave të tij në nivel rajonal apo kombëtar. Në Shqipëri ekzistojnë 9 institucione rezidenciale publike për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror, dhe dy qendra ditore të lokalizuara në disa rrethe të vendit, të ndarë sipas grupmoshave 0-3 vjeç 3-6 vjeç dhe 6-14 vjeç.

³ Referuar ligjit 9355 datë 10.03.2005 “ Për ndihmën dhe përkrahjen sociale”, neni 17.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

Institucionet private të përkujdesit, ndërkohë, organizohen si persona juridikë privatë që zhvillojnë veprimtari jofitimprurëse në përputhje me ligjet në fuqi dhe financohen nga organizata jofitimprurëse në formën e shoqatave fondacioneve apo qendrave vendase apo të huaja. Ato ofrojnë shërbime shoqërore private, ku përfshihen shërbimet e përkujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore apo në shtëpi, të financuara privatisht.⁴ Janë rreth 50 qendra përkujdesjeje jopublike nga të cilat 16 janë qendra rezidenciale dhe 34 qendra ditore. Në këto qendra trajtohen rreth 7661 fëmijë nga të cilët 402 në qendra rezidenciale dhe 7259 në qendra ditore të përkujdesit nga të cilët 904 i përkasin grupmoshës 0-6 vjeç, 3365 fëmijë janë të grupmoshës 6-15 vjeç dhe 2895 fëmijë të grupmoshës 15-18 vjeç. Llojet e shërbimeve në qendra ditore lidhen kryesisht me mbështetjen në komunitet, si shërbime për kopshtet, apo shkolla 5 vjeçare, mbështetje financiare, mbështetje shkollore, mbështetje psiko-sociale, formim profesional, ushqim apo zbatimje etj. Ndërkohë që qendrat rezidenciale ofrojnë përveç tyre edhe strehimin, shërbimin shëndetësorë, edukimin etj.

Shihet qartë nga të dhënat statistikore që në raport me institucionet publike të përkujdesjes, institucionet jopublike janë të orientuara më shumë në ofrimin e shërbimeve komunitare sesa atyre rezidenciale duke iu përshtatur më mirë nevojave të fëmijëve dhe tendencave drejt të cilave të çojnë situatat e reja ekonomike dhe sociale që po përjeton shoqëria shqiptare në ditët e sotme. Lidhur me cilësinë e shërbimit të ofruar konstatohet se institucionet private kanë një sërë avantazhet krahasuar me ato publike lidhur këto:

- Me mënyrën e organizimit të institucioneve (grupime të vogla shtëpi familje);
- Kohëzgjatjen e përkujdesjes (nga 0-18 vjeç);
- Ofrimin e përkujdesjes ndaj të miturve pa e diferencuar sipas grupmoshave.

3. Shtëpitë-familje si kujdestar të të miturve

Një formë e re për realitetin shqiptar është organizimi i qendrave rezidenciale në formën e shtëpi-familjeve. Shtëpitë familjare, të menaxhuara dhe të financuara nga organizata jofitimprurëse, janë një alternativë tjetër ndaj shërbimeve publike që u ofrohen fëmijëve pa kujdes prindëror, përkujdesjen me bazë komunitetin. Ky shërbim ka për qëllim të krijojë një mjedis sa më të afërt me familjen biologjike, dhe t'u japë fëmijëve mbështetje për një periudhë kohore relativisht të gjatë. Padyshim që tendenca bashkëkohore synon drejt zhvillimit të formave të kujdesit me bazë komunitetin apo familjen si më afër modelit të ambientit familjar të nevojshëm për rritjen dhe zhvillimin e të miturit jashtë përkujdesjes së prindërve natyrale të tij.

Përmendim si shembull mjaft të suksesshëm, SOS Fshati i Fëmijëve i cili përbën formën e përkujdesit shtëpi-familje. Në fshatin SOS i jepet përparësi fëmijëve jetimë biologjike, fëmijëve nga prindër të ndarë dhe fëmijëve prindërit e të cilëve nuk janë në gjendje të kujdesen për ta. Marrin përparësi vëllezërit dhe motrat. Numri i fëmijëve në familjen SOS shkon nga 5 në 7 vetë,

⁴ Referuar shifrave të dhëna nga MPCSSHB-Sektor i Analizave dhe Monitorimit të Varfërisë –dhjetor 2008.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

dhe ndryshe nga institucionet rezidenciale, vëllezërit dhe motrat nën moshën 16 vjeç nuk ndahen nga njëri-tjetri. Aktualisht po tentohet që edhe institucionet rezidenciale publike të reformohen dhe riorganizohen në formën e shtëpi-familje. Të dy shtëpitë e fëmijës (në Shkodër e në Tiranë) po shndërrohen gradualisht në shtëpi-familjare, duke marrë fëmijë që as nuk kthehen dot në familjet e tyre natyrore, as nuk mund të birësohen.

Pavarësisht se shihet si forma mbizotëruese e përkujdesjes sociale, vendosja e fëmijëve në përkujdesjen e institucioneve të përkujdesjes është parë nga legjislatori si alternativë e fundit për përkujdesjen e fëmijës jashtë familjes. Kjo për shkak edhe të disa pasojave negative që mund të shfaqen për shkak të institucionalizimit të fëmijëve, faktor që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në shumë raste në përjashtim social të tyre prej komunitetit ku jetojnë. Për këtë arsye shumë akte ndërkombëtare parashikojnë sigurimin e të drejtave specifike për fëmijët që jetojnë në institucionet e përkujdesjes.⁵ Në veçanti mund t'i referohemi rekomandimit (2005)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, mbi të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucione rezidenciale të përkujdesjes.

Sipas këtij rekomandimi, me qëllim respektimin e parimeve dhe të drejtave themelore për fëmijët jashtë kujdesit prindëror të vendosur në institucionet e përkujdesjes, duhet të mbahen në konsideratë disa të drejta themelore specifike si:

- Fëmijët mund të vendosen në këto institucioneve vetëm nëse kjo zgjedhje përkon me plotësimin e të drejtave dhe nevojave të tyre, sipas vlerësimit ndërdisiplinor dhe rishikimit të vazhdueshëm të ecurisë së tyre në këto institucione.
- Vendosja nën kujdestarinë e institucioneve nuk duhet të jetë afatgjatë, por të shihen alternativat e tjera të përkujdesjes.
- Këtyre fëmijëve, edhe pse janë larguar nga prindërit e tyre, duhet t'u sigurohen kontakte të rregullta me familjet e tyre.
- Fëmijët jashtë kujdesit prindëror të cilët janë motra dhe vëllezër kanë të drejtë të qëndrojnë bashkë në të njëjtin institucion dhe nëse nuk është e mundur të sigurohen kontaktet e rregullta midis tyre.
- Të drejtën për t'u respektuar dinjiteti i tyre.
- Të drejtën për respektim të përkatësisë etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore.
- Të drejtën për respektim të jetës private, dhe intimitetit të tyre gjatë jetesës në institucion.
- Të drejtën për një përkujdesje shëndetësore cilësore.
- Të drejtën për mundësi të barabarta arsimit, përkujdesi shëndetësor, kualifikimi profesional etj gjatë jetesës së tyre kolektive.

⁵ Recommendation Rec (2005) 5 of the Committee of Ministers to member states on the rights of children living in residential institutions.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

- Të drejtën për të pasur qasje në të gjitha llojet e shkollimit, trajnimit apo kualifikimit profesional.
- Të drejtën e pjesëmarrjes në vendimmarrjet lidhur me kushtet e jetesës së tij në institucion.
- Të drejtën për t'u informuar lidhur me të drejtat që ai ka dhe rregullat në institucionet e përkujdesjes.
- Të drejtën për t'u përgatitur për jetesën e pavarur apo kalimin në një formë tjetër përkujdesjeje.
- Të drejtën për t'u ankuar tek një organ i pavarur dhe i përcaktuar për të siguruar respektimin e të drejtave të tij themelore.

Por për realizimin sa më të mirë të tyre, nisur dhe nga mangësitë e përmendura ligjvënësi shqiptar është treguar i kujdesshëm për të minimizuar pasojat negative që mund të vijnë kryesisht për shkak të mënyrës së ndryshme të të jetuarit në këto institucione të jetesës kolektive. Neni 271 i Kodit të Familjes sanksionon të drejtën e këtyre institucioneve për të ushtruar kujdestarinë mbi të miturit, duke parashikuar si kriter ligjor licencimin e tyre. Një paketë e plotë ligjore përcakton rregulla ligjore mbi licencimin dhe veprimtarinë e institucioneve që ofrojnë shërbimin e përkujdesjes, si dhe mekanizmat shtetërorë të kontrollit të tyre. Megjithatë nuk do të kishim një mbrojtje të plotë të të drejtave të të miturve të vendosur në këto institucione, nëse shteti shqiptar nuk do të miratonte standartet e shërbimeve të përkujdesjes dhe mënyrën e zbatimit të tyre, nga subjektet e licencuar për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Standartet janë barometri i cilësisë së shërbimeve të ofruara, të mbështetura dhe në respektim të parimeve universale të të drejtave të njeriut si respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit, universaliteti, barazia e mundësive, e drejta për të përfituar, partneriteti, transparenca dhe paanshmëria, mosdiskriminimi, decentralizimi, pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit. Në kushtet e zhvillimit edhe të sektorit privat, të OJF-ve në shërbimet rezidenciale, lindi si nevojë imediate që shteti të vendoste disa rregulla dhe standarde për cilësinë e shërbimeve, që duhen respektuar nga të gjithë ofruesit e shërbimeve, nga institucionet publike, nga organizatat jofitimprurëse (OJF) dhe nga ofrues të tjerë private, standarte që padyshim është e nevojshme të rishikohen vazhdimisht për shkak të natyrës së veçantë dhe të subjektit që i ofrohen këto shërbime.

Duke iu referuar VKM nr 659, datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale mund të përmendim 12 standarte, përkatësisht përshtatshmëria e shërbimit; plani individual i përkujdesjes; ushqyerja; paraqitja, veshja, dhe nevojat materiale; sigurimi i shëndetit fizik, mendor dhe emocional; edukimi dhe argëtimi; ankimimi; mbrojtja nga abuzimi; mjedisi dhe akomodimi; stafi dhe menaxhimi; plani përgatitor për jetesë të pavarur. Udhëzimi i MPCSSHB Nr. 830, datë 14.4.2008 “ Për zbatimin e standarteve të

shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike” përcakton rregullat për mënyrën e zbatimit të tyre.

4. Në çfarë niveli është shkalla e respektimit të drejtave të fëmijëve në institucione përkujdesjeje?

Respektimi i të drejtave të fëmijëve, së pari si qenie njerëzore, dhe së dyti si një kategori sociale në nevojë, është një aspekt thelbësor në institucionet e përkujdesjes i cili duhet respektuar me rigorozitet dhe përpikmëri. Fëmijët e ndodhur në institucione rezidenciale duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat si çdo fëmijë tjetër që jeton në familjen natyrore, por fatkeqësisht këto të drejta nuk respektohen njëjloj në një pjesë të madhe rastesh edhe pse sigurimi dhe respektimi i tyre trajtohet në mënyrë specifike në aktet ndërkombëtare. Si rezultat i disa studimeve të kryera në këtë drejtim, fëmijët pa kujdes prindëror në këto institucione rrezikohen të abuzohen, shfrytëzohen dhe keqtrajtohen.⁶ Janë një numër faktorësh që pengojnë realizimin e përshtatshëm të të drejtave të fëmijës për të jetuar, për t’u zhvilluar e mbrojtur, si dhe për t’u këshilluar me ta kur merren vendime që kanë të bëjnë me të ardhmen e tyre si:

- mungesa e një legjislacioni të plotë;
- mangësitë e shërbimeve sociale të ngritura mbi bazë komuniteti;
- Modeli i papërshtatshëm i përkujdesjes dhe pamjaftueshmëria e shërbimeve sociale;
- Largimi nga përkujdesi në moshë të hershme dhe mungesa e shërbimeve mbështetëse;
- Mos-koordinimi i aktivitetit të strukturave të kujdesit në nivel kombëtar dhe lokal.
- Mostrajtimi si prioritet në politikat dhe strategjitë kryesore. Po ashtu edhe fakti që politikat dhe strategjitë kombëtare janë fragmentare dhe nuk japin një zgjidhje të fenomenit në tërësi.
- Stigma nga shoqëria duke i etiketuar ata si të këqij, të pandreqshëm dhe dembel është një tjetër pengesë për këtë kategori sociale.

Kështu referuar vëzhgimeve të dala nga studimi i UNICEF 2005 në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në të njëjtin vend së bashku me motrat apo vëllezërit e tjerë, realizimi i saj vështirësohet mjaft së pari për shkak të mënyrës së strukturimit të institucioneve rezidenciale të përkujdesjes si dhe ofrimit të përkujdesjes ndaj fëmijëve sipas grupmoshave dhe në afate kohore të pamjaftueshme. Në lidhje me të drejtën për ruajtjen e privatësisë, dinjitetit, intimitetit, të drejtën për t’u argëtuar dhe zhvilluar, vëzhgimi në raportin e UNICEF-it tregon se respektimi i saj lë shumë për të dëshiruar. Mosrespektimi i fëmijëve të vendosur në institucionet e kujdesit social buron nga damka që vihet mbi ta dhe përbuzja shoqërore.

⁶ Amnesty Interational; Albania: Adult orphans and the right to housing, November 2007; SOS Fshatrat e fëmijëve, Shqipëri-Të rinjtë pa kujdes prindëror –praktika, legjislacioni dhe të drejtat –tetor 2009, Raport studimor financiar nga UNICEF- Vlerësim i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijës dhe i institucioneve për fëmijët pa kujdes prindëror - tetor 2005.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

Në të njëjtën situatë ndodhemi edhe përsa i përket shkallës së respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur nga abuzimi, dhuna e keqtrajtimi. Ka pasur në media raportime për dhunë fizike të ushtruar ndaj fëmijëve në institucione, me raste që janë regjistruar në Tiranë, Sarandë dhe Vlorë.⁷ Fëmijët e të rinjtë jashtë kujdesit prindëror janë në risk të lartë për të qenë viktimat të trafikantëve apo për t'u shfrytëzuar nga punëdhënësit, ku jo në pak raste i paguajnë pak dhe nuk bëjnë sigurimin e tyre tek sigurimet shoqërore. Vajzat janë edhe viktimat potenciale të krimit të përdhunimit, trafikimit dhe përfshirjes në prostitucion. Disa vite më parë janë raportuar edhe raste përdhunimesh apo edhe rrëmbimesh me qëllim trafikimin. Sipas Raportit të Amnesty International: "Në 2006 një stacion televiziv në emisionin "Në kërkim të njerëzve të humbur" publikoi rastet e 11 vajzave jetime (me histori përkujdesi), të zhdukura gjatë 10 vjetëve të fundit. Njëra prej tyre rezultoi e zhdukur bashkë me fëmijën 18 muajsh."

Gjithashtu, mund të përmendim kronikat e shumta të shtypit të shkruar apo televizioneve shqiptare mbi raste të trafikimit, përdhunimit, apo dhe prostituimit të vajzave jetime. Së fundi, në datën 21 dhjetor 2009 është transmetuar në një stacion televiziv rasti i disa vajzave jetime të dala nga përkujdesja në shtëpitë e fëmijës në Shkodër të cilat prostituonin për të siguruar bukën e gojës. Një problem tjetër është rasti i fëmijëve me probleme sociale, probleme të cilat kanë ndikuar negativisht në sjelljen e fëmijës, duke e bërë atë shpeshherë të rrezikshëm për veten dhe për personat e tjerë. Edhe pse kjo është një e detyrë e institucionit të përkujdesjes, në disa raste ai ka nevojë për ndihmë të specializuar nga organet apo subjektet e specializuar për trajtimin e situatave të tilla. Mungesa e qendrave të riedukimit dhe trajtimit të fëmijëve e vështirëson dhënien e kësaj ndihme. Megjithatë mund të aplikohen praktika të ndjekura në vendet e tjera, psh mbikqyrja mund të kryhet nëpërmjet vizitave periodike nga punonjësi social, i cili do të ndjekë nga afër ecurinë e fëmijës gjatë periudhës së kujdestarisë. Një shembull tjetër është praktika gjyqësore në Angli. Situata të tilla rregullohen nëpërmjet vendimeve gjyqësore për vendosjen e fëmijës në qendra me elementë sigurie me qëllim parandalimin e dëmtimit të vetvetes apo të personave të tjerë. Gjithashtu përmendim praktikën në SHBA, aplikimin e programeve të trajtimit terapeutik ndërdisiplinor për trajtimin psikosocial të fëmijëve problematikë. Në udhëzimet për mënyrën e zbatimit të standarteve të përkujdesjes së fëmijëve në institucionet rezidenciale, parashikohet që e drejta e ankimit të aplikohet nëpërmjet depozitimit të ankesave në kutinë e ankimeve. Praktikisht kjo nuk është e mundur pasi këta fëmijë kanë frikë se do të paragjykojnë nga personeli i institucionit apo do të keqtrajtohen prej tij.

Një problem jo më pak i rëndësishëm është edhe zbatimi i planit të përgatitjes së fëmijës për t'u larguar nga përkujdesja. Referuar standarteve të përkujdesjes, përgatitja e fëmijës për t'u larguar nga shërbimi i kujdestarisë duhet të vijë si rrjedhojë e planit individual të fëmijës mbi përgatitjen e tij për largimin nga kujdestaria sipas procedurave ligjore. Ri-integrimi i fëmijës në familjen biologjike, familjen adoptive apo jeta e pavarur varet shumë nga përgatitja paraprake e fëmijës në këtë periudhë tranzitore. Ashtu si dhe procesi i sistemimit të fëmijës në kujdestarinë e

⁷ Të dhëna që përmbahen në studimin hulumtues *Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri*, të kryer në vitin 2005.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

kujdestarit të caktuar, përfundimi i vendosjes në kujdestari dhe largimi prej saj duhet të bëhet në mënyrë graduale. Vetëm në rastet emergjente, kur largimi gradual nuk është i mundur, do të gjendet një zgjidhje e menjëhershme ku fëmija të jetë i sigurt.

Politikat sociale në këtë drejtim synojnë drejt dhënies së mbështetjes së duhur si materiale ashtu dhe morale dhe psikologjike edhe pse në disa raste dështojnë në misionin e tyre. Nëse referohemi për argumentim të faktit, tek raporti i Amnesty International mbi hetimin e kryer lidhur me respektimin e të drejtave të jetimëve biologjikë apo socialë në institucionet e përkujdesjes, raporti shprehet se fëmijët që jetojnë në këto institucione janë të papërgatitur për jetën e pavarur pasi mbushin moshën 18 vjeç.⁸ Atyre nuk u sigurohet strehim dhe punë pasi përfundojnë shkollën edhe pse sipas parashikimeve ligjore kanë përparësi në sigurimin e të drejtave të tyre themelore për strehim, apo punësim, realizimi i të cilave është pjesë e mbështetjes pas largimit nga kujdestaria e institucioneve të përkujdesjes. Trajtimi me ndihmë ekonomike në rast papunësie për kategorinë e jetimëve mbi moshën 18 vjeç, duke u përfshirë në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike personalisht mendoj se nuk është në përshtatje me plotësimin e plotë të nevojave të tyre materiale. Këto faktorë bëjnë që të jenë më vulnerabël ndaj abuzimit seksual dhe shtatzënisë në moshë të hershme apo përfshirjes në rrjetet e trafikimit.

Të rinjtë me histori përkujdesi nga institucionet rezidenciale publike, manifestojnë edhe format më të këqija të rezultateve kur ata shpëputen nga përkujdesi: Ata përjetojnë varfëri afatgjatë, izolim social, shëndet të dobët, në jo pak raste janë përdorues të rregullt substancash të ndaluara, janë të pastrehë, të papunë afatgjatë, kanë një nivel të ulët shkollimi, dhe janë në risk të lartë për tu përfshirë në aktivitete të paligjshme, apo për të qenë të abuzuar nga keqbërës e trafikantë.

5. Përfundime dhe rekomandime

Dinamika e jetës sociale dhe problematikat që e pasojnë atë diktojnë nevojën e reformave ligjore dhe administrative në fushën e mbrojtjes sociale duke përfshirë këtu edhe kujdestarinë si një ndër format e përkujdesjes alternative për të miturit. Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve ekonomike dhe sociale me shtrirje të gjerë për fëmijët dhe familjet në nevojë mund të shërbejë si mjet për reduktimin e rasteve të ndarjes së fëmijëve nga familja natyrale e tij, apo të rritë mundësitë për rikthimin e shpejtë të fëmijës në familjen e tij natyrale. Por nëse ndarja e fëmijës nga familja e origjinës është e pashmangshme, duhet të merren masa për sigurimin e alternativës më të mirë të përkujdesjes për të, duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, dhe mbi bazë të një vlerësimit të hollësishëm të rastit konkret.

Miratimi i Kodit të Familjes në vitin 2003, solli një sërë risish në legjisllacionin shqiptar në lidhje me rregullimin ligjor të institutit e kujdestarisë dhe marrëdhënieve që krijohen prej saj. Megjithatë, në praktikë do të ndeshen edhe shumë probleme që padyshim kërkojnë një zgjidhje efektive në funksion të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Një pjesë e këtyre

⁸ Ligji nr 8153 dt 31.10.1996 “ Për statusin e jetimit”§ 6-18.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

problemeve lidhet me aspektet procedural të vendosjes së të miturit në përkujdesjen e këtyre institucioneve dhe një pjesë e problemeve lidhen me nevojën për reformim ligjor dhe administrativ.

Tendencat bashkëkohore diktojnë nevojën e zhvillimit të sistemeve të kujdestarisë tradicionale si kujdestaria nga të afërmit, apo kujdestaria me bazë komunitetin përkundrejt atij institucional, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të drejtave të fëmijës të njohura nga konventat. Por nëse mundësia e vetme e përkujdesjes së fëmijës është institucionalizimi, atëherë duhet të merren masa të përshtatshme për të siguruar që fëmijët në kujdestarinë e institucioneve të përkujdesjes të mos stigmatizohen gjatë qëndrimit në të.

- Shteti duhet të ndërmarrë hapa reale për të ndryshuar strukturën e institucionet tradicionale, duke krijuar grupime më të vogla brenda institucioneve, dhe duke rritur në të njëjtën kohë si numrin e personelit që punon me fëmijët dhe nivelin e profesionalizimit të tyre. Lidhur me riorganizimin e institucioneve të përkujdesjes, një model i mirë ka rezultuar organizimi i fshatit SOS, ku fëmijët jetojnë në grupe të vogla të organizuara si shtëpi familje. Transformimi i institucioneve të përkujdesjes në grupime të vogla shtëpi-familje brenda saj do të ishte më elastik në plotësimin e nevojave të ndryshme.
- Zgjatja e afatit të ofrimit të përkujdesjes minimalisht derisa fëmija të mbushë moshën 18 vjeç do të ishte e këshillueshme.
- Njëkohësisht marrja e masave për mbajtjen e vëllezërve dhe motrave në të njëjtin vend pavarësisht grupmoshave që u përkasin është një tjetër sugjerim që duhet pasur parasysh në të ardhmen.
- Pavarësisht se tashmë ekziston paketa ligjore dhe nënligjore që përcakton standartet e përkujdesjes për institucionet rezidenciale publike dhe jo publike, si dhe rregulla të qarta për mënyrën e zbatimit të tyre së bashku me një kontroll periodik nga strukturat shtetërore përgjegjëse, roli i institucioneve shtetërore kontrolluese është ende i nevojshëm për zgjidhjen e problemeve që dalin në praktikë.
- Plani i përkujdesjes gjatë dhe pas largimit të fëmijës nga institucioni rezidencial nuk gjen zbatim për shkak të mangësive ligjore dhe mungesës së infrastrukturës administrative që do të zbatojë planin e përkujdesjes gjatë dhe pas daljes nga kujdestaria, si mbështetja financiare, morale, emocionale e fëmijës, plotësimin e nevojave të tyre me qëllim integrimin e plotë në komunitetin ku do të jetojnë në vazhdim.

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

- Në lidhje me periudhën tranzitore të kalimit të fëmijës nga përkujdesja institucionale në jetën e pavarur duhet të merren masa për lehtësimin e këtij procesi, p.sh. duke siguruar një person kontakti për fëmijën.
- Për jetimët biologjikë ka parashikime të mira ligjore lidhur me mbështetjen që duhet të sigurojë shteti, përsa i përket përparësive për trajtimin me strehim, dhënies së ndihmës së ekonomike përsa kohë ai nuk ka siguruar punë, si formë e mbështetjes financiare, trajtimin me bursë studimi dhe mbulimin e shpenzimeve të shkollimit, apo kualifikimit profesional të tyre etj. Ndërkohë mungojnë parashikimet ligjore për jetimët socialë.
- Pjesë e rëndësishme e administrimit të kujdestarisë në të gjithë format e saj është financimi i shërbimit. Financimi i studiuar i shërbimit të kujdestarisë në funksion të përmbushjes së nevojave të të miturve ka impakt të drejtpërdrejtë në kushtet e përkujdesjes rritjes dhe edukimit apo kujdesit shëndetësor të fëmijëve. Kjo mund të arrihet me zhvillimin e politikave shtetërore të orientuara drejt rritjes së përkrahjes dhe mbrojtjes sociale për këtë kategori specifike të shoqërisë shqiptare. Duhet të theksojmë që rritja e mbështetjes financiare dhe alokimi eficient i fondeve buxhetore duhet të shihet me përparësi edhe në format e kujdestarisë nga të afërmit e fëmijës apo institucionet e përkujdesjes.
- Konstatohet mungesa e një definicioni të qartë ligjor të konceptit të “fëmijës në rrezik” e cila e bën të vështirë identifikimin e rastit dhe si rrjedhim edhe sigurimin e mbrojtjes nga format e dhunimit të drejtave të fëmijëve.
- Hetimi dhe dokumentimi i situatave apo dhe informacionit bazë mbi fëmijët është një problem që ndeshet shpesh. Për këtë qëllim kërkohet që të gjithë fëmijët që ndodhen në përkujdesjen e institucionet rezidenciale publike apo private, dhe fëmijët që duhet të vendosen në kujdestari duhet t’u bëhet një hetim i përshtatshëm social dhe të ketë një dokumentacion të shkruar të detajuar i cili e ndjek fëmijën kudo që të ndodhet gjatë gjithë periudhës së kujdestarisë. Dosjet shumë-disiplinore duhet të përditësohen dhe të plotësohen gjatë zhvillimit të fëmijës.
- Marrja e masave ligjore për krijimin e një sistemi kombëtar monitorimi të drejtave të fëmijëve edhe pse në disa raste sporadike janë krijuar të tillë në disa njësi të qeverisjes vendore. Për këtë rekomandohet që shteti të krijojë një mekanizëm të pavarur monitorimi për fëmijët jashtë kujdesit prindëror.
- Krijimi i Institucionit të Avokatit të Fëmijëve apo një seksioni të veçantë brenda Institucionit të Avokatit të Popullit të veshur me atributet e nevojshme duke përfshirë dhe ato investuese për fillimin e procedimeve gjyqësore në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

PROMOVIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËN KUJDESTARINË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE

jashtë kujdesit prindëror mund të jetë një shembull i këtij organi të pavarur monitorues dhe kontrollues.

Theksojmë edhe njëherë se problemi i të miturve është objekt i një vëmendjeje dhe përpjekjeje të madhe e shtetit shqiptar i cili në mënyrë të vazhdueshme ka tentuar të përmirësojë shërbimet e përkujdesjes ndaj kësaj kategorie nëpërmjet rritjes së shërbimeve të përkujdesjes si dhe miratimit të legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë ende ekzistojnë hendeqe të thella si në shërbimet e ofruara ashtu edhe në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të miturve që kërkojnë ndërhyrje me përparësi nga ana e qeverisë dhe autoriteteve publike në këtë sektor. Marrja e masave emergjente si përmirësimi i legjislacionit dhe ndërmarrja e reformave të sistemit gjyqësor dhe atij administrativ, do të ishin tepër të nevojshme për rregullim sa më efikas të kësaj marrëdhënie dhe reduktim të ndjeshëm të disa prej problematikave kryesore të ndeshura në realitetin shqiptar lidhur me përkujdesjen ndaj të miturve.

**THE PROMOTION AND PROTECTION OF THE RIGHTS OF CHILDREN IN THE
CARE OF SOCIAL INSTITUTIONS**

Abstract: The phenomenon of juveniles growing up out of parental care is a social phenomenon that has accompanied the Albanian society over time and especially after the political, economic and social changes of 1990-s. To solve the social problems that this phenomenon creates, the Albanian Government has engaged in the design and implementation of the social care system for juveniles, in accordance with international principles of safeguarding the highest interest of the minors. Guardianship and adoption among others are found as a legal solution to protect the rights of minors out of parental care.

After presenting the dimensions of the phenomenon of minors whom remain out of parental care in the Albanian reality, this study analyzes the legal framework of the system of social care for juveniles. The study shall research and compare the Albanian legislation covering the system of social care through public or private institutions. In dealing with the main standards of the social care service, the study highlights some problems encountered during their implementation in practice and makes a number of recommendations for further improvement of standards and concrete ways of ensuring the security and protection of the rights and interests of juveniles out of parental care.

Keywords: The juvenile system, caretaker, public and private care institutions, standards for the treatment of juveniles.